



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 244 Prot.

Tiranë, më 02.04 2015

VENDIM Nr. 31, datë 1.04.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë Nr. 5, datë 1.04.2015, i mbledhur jashtë radhe, posaçërisht në vijim të korrespondencës dhe takimeve ndër-institucionale të zhvilluara në zbatim të vendimit të KKA Nr. 367 i datës 12.12.2014, në lidhje me problematikën e shkaktuar si rezultat i mbivendosjes brenda zonës "B", të propozuar nga Instituti i Arkeologjisë (Misioni Arkeologjik Shqiptaro-Francez i Komanit), të shtyllave të një segmenti të projektit "Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë"-OST sh.a.,

VENDOSI:

- I. Të miratojë propozimin e paraqitur në këtë mbledhje nga OST sh.a., të gjurmës së zhvendosur të një segmenti të "Linjës së transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë". (Bashkëlidhur propozimi i gjurmës, identifikuar me ngjyrë blu, në hartën bashkëlidhur këtij vendimi)
- II. OST sh.a. të depozitojë pranë ASHA, projektin e zbatimit për propozimin e ri të paraqitur të gjurmës së zhvendosur nga projekti fillestar, i cili do të shqyrtohet në KKA e rradhës.
- III. Në varësi të këtij projekti, KKA do të përcaktojë pozicionet e shtyllave, për të cilat do të kryhen sondazhe arkeologjike, duke lidhur aktmarrëveshje përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al



Koman

2q

55

Linje e Re 400 kV

54

53

52

51

50

49

48

47

Zona e germimeve Arkeologjike

2

3

Image © 2015 CNES / Astrium

Google earth

2006

Imagery Date: 9/21/2013 34 T 402326.83 m E 4661407.79 m N elev 73 m eye alt 3.01 km